



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

An aerial photograph of Tirana, Albania, showing a dense urban landscape with various buildings, green spaces, and mountains in the background. The image is partially covered by a blue gradient overlay at the bottom.

RAPORT MBI AKTIVITETIN E KI 2024

Këshilli i Investimeve (KI) ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. KI kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që nxisin mirëfunksionimin e tregut.

KI kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje përfaqësues të qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve për zhvillim.

KI mbështetet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).



PËRMBAJTJA

Hyrje	6
Kalendari i aktiviteteve kryesore	8
Klima e Investimeve	10
Mbledhje të Këshillit të Investimeve	12
Konsultime Teknike	18
Rekomandime të Përmbushura	20
Forcimi i Zbatimit të Reformave	22
Komunikim dhe Vizibilitet	23
Angazhimi i Partnerëve	24
Avokim dhe Ndërgjegjësim	26
Anketat e KI	30
Dokumente	31
Planet për të ardhmen	32
Numra të rëndësishëm	34
Anëtarë të KI	35



“ E veçanta dhe kryesorja që vlen të përmendet për Këshillin e Investimeve është mënyra e komunikimit të hapur dhe të drejtpërdrejtë. Ky këshill është një platformë ku idetë dhe shqetësimet ndahen pa dorashka, duke krijuar një hapësirë të sinqertë dhe të ndershme dialogu. Kjo mënyrë e punës kontribuon në rritjen e transparencës, përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe nxitjen e investimeve në Shqipëri. Për këtë arsye, jam shumë krenar për këtë këshill dhe e çmoj gjithmonë diskutimin e hapur që zhvillohet këtu.

Z. Blendi Gonxhja
Kryetar i Këshillit të Investimeve
 Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
 12 nëntor 2024

OBJEKTIVAT E VEPRIMTARISË GJATË VITIT 2024

Në përputhje me qëllimin kryesor të Këshillit të Investimeve (KI) për forcimin e besimit ndërmjet aktorëve kryesorë dhe institucionalizimin e dialogut politik mbi klimën e investimeve në vend, puna e Sekretariatit u përqendrua në këto shtylla kryesore:

PËRAFRIMI I AGJENDËS SË KI-SË ME PRIORITETET E KLIMËS SË INVESTIMEVE DHE NEVOJAT E BIZNESIT VENDAS

Realizuar përmes një procesi të vazhdueshëm informimi dhe konsultimi, i cili përfshin anketa vjetore, dialog të drejtpërdrejtë me aktorët kyç, hulumtimin e raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përditësime periodike të treguesve makroekonomikë të vendit. Gjithashtu, angazhimi proaktiv i Sekretariatit në nisma, evente dhe platforma të rëndësishme të lidhura me procesin e integritimit evropian ka forcuar kapacitetin për të identifikuar prioritetet e reformave dhe për të adresuar sfidat kryesore që prekin klimën e investimeve, duke i vendosur ato në qendër të një dialogu të mirëstrukturuar brenda KI-së.

KOORDINIMI I PËRFAQËSIMIT GJITHËPËRFSHIRËS TË SHOQATAVE TË BIZNESIT NË KI

Numri i përfaqësuesve të shoqatave të biznesit me

mandat dyvjeçar u rrit nga katër në tetë, përmes një procesi të strukturuar rotacioni, të projektuar për të garantuar një përfaqësim më të gjerë dhe gjithëpërfshirës të interesave të sektorit privat. Kjo qasje synon të forcojë zërin e komunitetit të biznesit dhe të promovojë një dialog më të balancuar, konstruktiv dhe efektiv me politikëbërësit.

KRIJIMI I KUSHTEVE PËR DIALOG TË STRUKTURUAR

Përmes hartimit me kujdes të agjendave të mbledhjeve të Këshillit, të bazuara në një proces gjithëpërfshirës konsultimi dhe votimi, organizimit të mbledhjeve plenare me përfaqësim të gjerë e të balancuar, si dhe shpërndarjes në kohë të materialeve teknike dhe procesverbaleve përkatëse, Sekretariati ka krijuar kushtet për një dialog të mirëstrukturuar dhe me vlerë të shtuar për politikëbërjen.

AVOKIMI PËR VEPRIME PRIORITARE NË POLITIKË

Sekretariati ka luajtur një rol aktiv në nxitjen e dialogut politik përmes pjesëmarrjes në aktivitete të organizuara nga partnerët dhe në panele të nivelit të lartë, duke promovuar rekomandimet të KI në fusha si sundimi i ligjit, inovacioni dhe integrimi evropian. Këto angazhime kanë theksuar rëndësinë e hartimit të reformave të bazuara në evidencë, në përputhje me nevojat e sektorit privat dhe prioritetet strategjike të zhvillimit kombëtar.

MONITORIMI SISTEMATIK I PROGRESIT TË REKOMANDIMEVE TË KI-SË

Përmes zbatimit të një mekanizmi të strukturuar për monitorimin e progresit të rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse, përditësimit të vazhdueshëm të një baze të dhënash mbi rezultatet dhe publikimit të rregullt të raporteve vjetore, Sekretariati ka synuar të promovojë transparencën dhe të forcojë llogaridhënien institucionale në procesin e reformave.

HYRJE

Mirë se vini në Raportin Vjetor të Këshillit të Investimeve (KI) për vitin 2024 – një pasqyrë gjithëpërfshirëse e nismave, rezultateve dhe angazhimit të ndërmarrë për nxitjen e një dialogu të strukturuar dhe efektiv për përmirësimin e klimës së biznesit në vend. Në përputhje me objektivat e procesit të integrimit evropian, KI ka punuar gjithashtu për përafrimin e agjendës së tij me acquis të Bashkimit Evropian (BE) dhe kërkesat e tregut të vetëm evropian, duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë dhe integrimin më të plotë të biznesit vendas në tregjet evropiane.

NGJARJET KRYESORE

- » Gjatë vitit 2024, KI organizoi tre mbledhje plenare dhe shtatë tryeza teknike, duke angazhuar 143 biznese nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Si rezultat i këtyre diskutimeve, u formuluan 24 rekomandime të reja për përmirësimin e klimës së investimeve në vend.
- » Që prej krijimit të tij në vitin 2015, KI ka miratuar gjithsej 350 rekomandime për përmirësimin e klimës së investimeve. Deri më sot, rreth 47% e tyre janë zbatuar në masë të konsiderueshme, 17% janë në proces zbatimi, ndërsa 36% mbeten ende të pazbatuara – kryesisht në fusha komplekse si siguria ligjore e pronës, zhvillimi i potencialit të investimeve dhe promovimi i burimeve alternative të energjisë.
- » Në përputhje me parimet e përfaqësimit gjithëpërfshirës, gjatë vitit 2024 u realizua rotacioni i përfaqësuesve jo të përhershëm të shoqatave të biznesit, mbajtës të mandatit dyvjeçar. Procesi u bazua në një listë të përgatitur nga Sekretariati dhe të miratuar nga Kryetari i Këshillit, me synimin për të garantuar përfaqësim të balancuar dhe rotacion transparent të interesave të sektorit privat.
- » Në zbatim të VKM nr. 754, datë 20.12.2023, përfaqësimi i shoqatave të biznesit në KI u zgjerua me katër anëtarë të rinj, duke e çuar numrin total të përfaqësuesve të sektorit privat në 13.

» Anëtarët e Këshillit votuan për temat prioritare të vitit 2024, me fokus në rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve vendase, lehtësimin e aksesit në tregun e Bashkimit Evropian për produktet shqiptare jo-ushqimore, si dhe adresimin e sfidave të financimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM).

» Një nga shtyllat kryesore të punës së Këshillit gjatë këtij viti ka qenë përafrimi i agjendës me nevojat e sektorit privat për të përmbushur standardet e tregut të vetëm të BE-së dhe për të shfrytëzuar në mënyrë më efektive mundësitë që ky treg ofron për zhvillimin ekonomik të vendit.

» Pas ristrukturimit të institucioneve qeveritare, KI u drejtua nga kryetari i ri, z. Blendi Gonxhja, Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, i cili udhëhoqi mbledhjet e Këshillit gjatë gjithë vitit 2024.

» Sekretariati hartoi 10 analiza teknike dhe realizoi 5 vrojtime, me pjesëmarrjen e 984 kompanive, duke siguruar një bazë të fortë të dhënash dhe perceptimesh të vlefshme për formulimin e rekomandimeve të Këshillit.


» Sekretariati kontribuoi në 16 ngjarje të nivelit të lartë, duke marrë pjesë si panelist në disa prej tyre, çka forcoi pozicionin e Këshillit si një aktor i besueshëm në procesin e politikëbërjes dhe si një nxitës aktiv i reformave të nevojshme.

Gjetjet nga Raporti i Vlerësimit të Partnerëve të KI (2024) treguan një mbështetje të fortë dhe të qëndrueshme për misionin dhe aktivitetet e tij. Rreth 96% e anëtarëve dhe partnerëve e perceptojnë Këshillin si një platformë të rëndësishme për dialog të strukturuar, me një rol efektiv në avokim dhe një qasje gjithëpërfshirëse në procesin e formulimit të politikave. Performanca e Këshillit gjatë vitit 2024 konfirmoi edhe një herë rolin e tij të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi që promovon politika të bazuara në evidencë, fuqizon zërin e sektorit privat dhe mbështet përpjekjet kombëtare për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.



KALENDARI I AKTIVITETEVE KRYESORE

gjatë vitit 2024



KLIMA E INVESTIMEVE

Ekonomia shqiptare u rrit me 3.96% në vitin 2024, e nxitur kryesisht nga performanca e fortë e sektorëve të turizmit dhe ndërtimit. Banka Botërore parashikon një rritje mesatare vjetore prej 3.1% për periudhën 2025–2027, e mbështetur nga kërkesa e qëndrueshme e brendshme, rritja e konsumit dhe investimet në infrastrukturë.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan një rritje prej 5.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 1.6 miliardë euro gjatë vitit 2024. Stoku i IHD-ve përbënte 62.1% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), ndërsa vendet kryesore investitore përfshinin Turqinë, Italinë dhe Holandën. Sektori i pasurive të paluajtshme mbeti destinacioni kryesor i investimeve. Ndërkohë, inflacioni ra në 2.2%, që nga shkurti 2024 duke qëndruar nën objektivin 3% të Bankës së Shqipërisë.

Në planin politik, Shqipëria shënoi përparim të dukshëm në procesin e anëtarësimit në Bash-

kimin Evropian, me hapjen zyrtare të negociatave për dy klastera në tetor dhe dhjetor 2024. Ndërkohë, themelimi i Komisionit Kundër Korrupsionit përbën një hap të rëndësishëm drejt reformimit të qeverisjes, edhe pse përfshirja e kufizuar e opozitës reflektoi vazhdimin e polarizimit politik. Këto zhvillime përputhen me objektivin e Shqipërisë për anëtarësim në BE deri në vitin 2030.

Në nivel institucional, u shënuan ndryshime në drejtuesit e disa institucioneve dhe u ndërmorën nisma të reja për përmirësimin e qeverisjes ekonomike dhe dialogut me palët e interesuara. Disa nga zhvillimet kryesore legjislative ishin: një ligj i ri për inspektimet, një projektligj për anëtarësimin e detyrueshëm të biznesit në Dhomën Ekonomike Kombëtare dhe një ligj gjithëpërfshirës për mbrojtjen e të dhënave, në përputhje me standardet e BE-së. Qeveria miratoi gjithashtu Agjendën Kombëtare të Reformave dhe buxhetin e shtetit për vitin 2025, ndonëse polarizimi politik kufizoi diskutimet e gjera në kuvend.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan një rritje prej 5.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 1.6 miliardë euro gjatë vitit 2024



MBLEDHJE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE



1. Sfidat e sektorit privat – informaliteti, produktiviteti dhe inovacioni

Cilat janë pengesat kryesore që përballin bizneset në përpjekjet e tyre për të rritur investimet, për të përmirësuar produktivitetin dhe për të rritur konkurrueshmërinë në tregjet rajonale dhe globale?

Pse ndërmarrjet shqiptare hezitojnë të investojnë në Kërkim dhe Zhvillim (K&ZH)?

Cilat janë pengesat më të mëdha për integrimin e tyre në zinxhirët ndërkombëtarë të vlerës?

Diskutimi mbi informalitetin, produktivitetin dhe inovacionin u zhvillua në një moment kyç, teksa Shqipëria përshpejton rrugën e integritetit në Bashkimin Evropian dhe synon një përfshirje më të gjerë në ekonominë rajonale dhe globale. Mbështetja historike në krahun e lirë të punës po bëhet gjithnjë e më e paqëndrueshme për shkak të emigracionit të lartë dhe mungesës së aftësive të specializuara. Informaliteti vijon të shtrembërojë konkurrencën e ndershme dhe të ulë të ardhurat buxhetore, ndërkohë që niveli i ulët i produktivitetit dhe mungesa e investimeve në teknologji dhe K&ZH mbeten sfida kryesore për konkurrueshmërinë dhe inovacionin.

REKOMANDIME KRYESORE

- **Modernizimi i Administratës Fiskale:** Ministria e Financave, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, duhet të avancojë drejt një ligji të unifikuar për procedurat tatimore, të hartojnë një strategji kombëtare për mbledhjen e të ardhurave dhe të sigurojnë koordinim më të mirë midis rregulloreve fiskale qendrore dhe lokale. Qëllimi është thjeshtimi dhe standardizimi i procedurave për të ndërtuar një mjedis fiskal të parashikueshëm dhe më miqësor për biznesin.
- **Politika Fiskale për Inovacionin dhe Produktivitetin:** Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) duhet të udhëheqë zbatimin e stimuljeve fiskale për nxitjen e inovacionit në biznes, përfshirë amortizimin e përshpejtuar dhe njohjen e shpenzimeve për K&ZH. Objektivat e produktivitetit duhet të integrohen në planifikimin fiskal, ndërsa mbështetja duhet të fokusohet në sektorë prioritarë si turizmi, energjia dhe bujqësia, për të forcuar inovacionin dhe konkurrueshmërinë.
- **Masat Mbështetëse të Inovacionit Specifik për Sektorin:** Grupet e punës ndërminstrore, duke përfshirë Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Turizmit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, duhet të realizojnë analiza të thelluara për sektorët strategjikë me qëllim identifikimin e masave konkrete për rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë përmes politikave të synuara të inovacionit.
- **Rritja e ndërgjegjësimit për Partneritetet Publiko-Private për Inovacionin:** Rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe biznesit në krijimin e qendrave të inovacionit dhe K&ZH. Fushatat kombëtare të ndërgjegjësimit dhe krijimi i platformave koordinuese janë thelbësore për të maksimalizuar potencialin e inovacionit, përfshirë atë në fushën e inteligjencës artificiale.



Nevojitet një koordinim më i madh për iniciativat e inovacionit dhe inteligjencës artificiale, pasi këto fusha përfshijnë ministri të shumta dhe kërkojnë bashkëpunim në nivel më të lartë. Krijimi i platformave të tilla si këshillat ose grupet e punës mund të rrisë përpjekjet e koordinimit dhe të sigurojë që Shqipëria të shfrytëzojë në mënyrë efektive talentin në dobi të vendit.



Z. Grant Van Cleve
President, AmCham Albania, 26 mars 2024

MBLEDHJE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE



2.

Mbi Rritjen e Konkurrueshmërisë dhe Aksesit në Treg të Produkteve Shqiptare Jo-Ushqimore sipas Standardeve Evropiane

A janë bizneset shqiptare të gatshme të konkurrojnë në tregun e BE-së?

Cili është roli i mbështetjes institucionale për përafrimin me standardet evropiane?

Si mund të përballohen kostot e larta për zbatimin dhe mirëmbajtjen e standardeve?

Përmirësimi i konkurrueshmërisë dhe rritja e aksesit në treg për produktet jo-ushqimore që përmbushin standardet evropiane është një prioritet kyç në rrugën e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Shumë biznese, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), përballen me sfida të shumta si rregullore të vjetruara, mbështetje institucionale të kufizuar dhe ndërgjegjësim të ulët mbi kërkesat e përputhshmërisë. Kostot e larta për përmbushjen e standardeve, mungesa e ekspertizës teknike dhe infrastruktura e papërshtatshme mbeten pengesa madhore për pajtueshmërinë me normat e BE-së. Ndërkohë që disa kompani po investojnë në përmirësimin e cilësisë me synim hyrjen në tregun evropian, shumë të tjera vazhdojnë të fokusohen në tregjet lokale apo rajonale për shkak të kufizimeve financiare. Pavarësisht përpjekjeve për harmonizimin e legjislacionit, forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes së tregut dhe krijimin e platformave informative si portalet unike, sfidat e zbatimit dhe mungesa e koordinimit ndërinstitutional vazhdojnë të frenojnë progresin. Për këtë arsye, nevojiten hapa të mëtejshëm konkretë për të përmirësuar klimën e eksportit dhe për të siguruar që bizneset shqiptare të jenë të përgatitura për tregjet e huaja.

REKOMANDIME KRYESORE

- **Zhvillimi i një baze të dhënash kombëtare të prodhuesve dhe identifikimi i potencialit për eksport.** Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) duhet të ndërmarrë krijimin e një baze të dhënash gjithëpërfshirëse të prodhuesve vendas, të klasifikuar sipas kategorive të produkteve. Përmes analizave sektoriale, kjo bazë do të ndihmojë në identifikimin e ndërmarrjeve me potencial të lartë për eksport dhe në hartimin e politikave të synuara për mbështetje teknike dhe financiare.
- **Përshtatja rregullatore dhe forcimi i zbatimit të ligjit:** MEKI, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), duhet të përshpejtojë procesin e transpozimit të legjislacionit të BE-së, me fokus të veçantë në sektorin e ndërtimit dhe të produkteve industriale. Po ashtu, sistemet e inspektimit duhet të përmirësohen përmes forcimit të kapaciteteve profesionale, garantimit të integritetit dhe rritjes së transparencës. Krijimi i mekanizmave të sinjalizimit “whistleblowing” mund të ndihmojë në uljen e praktikave korruptive dhe në forcimin e besimit të biznesit.
- **Rritja e kapaciteteve teknike të dhomave të tregtisë dhe shoqatave të biznesit:** Dhomat e tregtisë dhe organizatat përfaqësuese të sektorit privat duhet të fuqizojnë aftësitë e tyre teknike për të ofruar mbështetje të specializuar dhe informacion të përditësuar për anëtarët e tyre. Kjo përfshin trajnime mbi kërkesat e BE-së, udhëzime për certifikimet ndërkombëtare dhe asistencë për përmbushjen e standardeve të sigurisë, cilësisë dhe mjedisit në linjë me kërkesat evropiane.

“Shqipëria duhet t’i japë përparësi sektorëve ku ka një avantazh konkurrues – siç janë bujqësia, ndërtimi dhe energjia – për të nxitur eksportet. Ndërtimi i një baze të dhënash të detajuar të produkteve të gatshme për eksport dhe sigurimi i certifikimeve ndërkombëtare si Global GAP janë kyçe për të hyrë në tregjet globale. Investimi në arsim, aftësi të specializuara dhe industri teknologjike do ta vendosnin Shqipërinë në të njëjtën trajektore si Polonia, Bullgaria apo Rumania.

Z. Ardian Lekaj

Kryetar, Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, 03 shtator 2024

Lexo më shumë: [Notë Teknike “Mbi Rritjen e Konkurrueshmërisë dhe Aksesit në Tregje të Produkteve Shqiptare Jo-Ushqimore me Standarde Evropiane \(Perceptime të Biznesit\)”](#)

MBLEDHJE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE



3.

Përmirësimi i Aksesit në Instrumentet e Financimit

Cilat janë pengesat kryesore me të cilat përballen NMVM-të në Shqipëri në përpjekjet për të siguruar financim?

Çfarë hapash mund të ndërmerren për të reduktuar barrierat burokratike dhe për të thjeshtuar procesin e aplikimit për kredi?

Si mund të përmirësohen dhe zgjerohet ndikimi i skemave të garancisë së kreditit, veçanërisht për grupet e pashërbyera si gratë sipërmarrëse?

Aksesi në financim mbetet një ndër sfidat më të mëdha për NVM-të në Shqipëri. Pavarësisht përparimeve në përafrimin e kuadrit ligjor financiar me standardet e BE-së dhe zgjerimit të shërbimeve bankare digjitale, NMVM-të hasin ende pengesa të konsiderueshme, përfshirë kërkesat e larta për kolateral, histori të kufizuar krediti, procedura të ndërlikuara të huadhënies dhe norma të larta interesi. Ndërkohë që teknologjia financiare dhe digjitalizimi po zhvillohen me ritme të shpejta, instrumente si financimi kolektiv “crowdfunding” dhe banking-u i hapur “open banking” mbeten të pazhvilluara për shkak të boshllëqeve në legjislacion dhe rregullim. Ekonomia informale, që përfaqëson rreth 30% të PBB-së, e kufizon më tej mundësinë e aksesit në financim formal. Institucionet financiare ndërkombëtare dhe sektori i mikrofinancës ofrojnë disa mundësi, përfshirë kredi të aksesueshme dhe garanci të pjesshme, por përfshirja mbetet e kufizuar për shkak të ndërgjegjësimit të ulët dhe procedurave burokratike. Edhe skemat e garancisë sovraane kanë mbetur kryesisht të pashfrytëzuara për shkak të joefikasitetit dhe mungesës së mekanizmave të qartë monitorimi dhe vlerësimi. Përpjekjet e qeverisë për modernizimin e sistemit të pagesave dhe për rritjen e përfshirjes financiare janë të mirëpritura, por ende ekzistojnë boshllëqe në edukimin financiar, mungesë e produkteve të personalizuar dhe shërbimeve këshillimore të dedikuara për bizneset e vogla.

REKOMANDIME KRYESORE

- **Krijimi i një baze të dhënash të unifikuar për NMVM-të dhe përmirësimi i koordinimit institucional:** Banka e Shqipërisë (BSH), INSTAT dhe Qeveria mund të bashkëpunojnë për krijimin e një baze të dhënash të centralizuar mbi huadhënien për NMVM-të, të ndarë sipas sektorëve, qëllimit të huasë dhe gjinisë së përfituesve. Një bazë e tillë do të ndihmonte në formulimin e politikave të synuara dhe në zhvillimin e instrumenteve financiare të personalizuar.
- **Rishikimi dhe forcimi i skemave të garancisë së kreditit:** Ministria e Financave, MEKI dhe BSH inkurajohen të kryejnë një vlerësim gjithëpërfshirës të skemave aktuale të garancisë sovraane, duke identifikuar pengesat ekzistuese dhe duke përcaktuar tregues të matshëm të performancës dhe ndikimit. Qasja më gjithëpërfshirëse dhe fokusimi tek grupet e pashërbyera, përfshirë gratë sipërmarrëse, duhet të jenë prioritetet kyçe.
- **Thjeshtimi i procedurave të huadhënies dhe digjitalizimi i të dhënave publike:** Institucione si Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe BSH mund të punojnë së bashku për të lehtësuar aksesin e institucioneve financiare në të dhëna zyrtare përmes platformës e-Albania. Kjo përfshin përmirësimin e regjistrimit të kolateralit dhe reduktimin e pengesave administrative që rëndojnë mbi procesin e huadhënies.
- **Përshtetimi i digjitalizimit në sektorin bankar dhe promovimi i banking-ut të hapur:** Sistemi bankar këshillohet të përshteptojë miratimin e parimeve të banking-ut të hapur dhe të zgjerojë përdorimin e mjeteve digjitale për të ofruar shërbime më transparente, të efektshme dhe konkurruese. Këto zhvillime do të përmirësonin përvojën e klientëve dhe do të hapnin rrugë për produkte financiare më të përshtatura për NMVM-të.



Gratë sipërmarrëse përballen me sfida të mëdha për të siguruar financim, për shkak të mungesës së kolateralit dhe të drejtave të pasigurta të pronësisë, të cilat vështirësojnë aplikimet për kredi. Pavarësisht ekzistencës së ligjeve që synojnë barazi, zbatimi i tyre mbetet i dobët. Burokracia, mungesa e informacionit dhe njohuritë e kufizuara financiare e përkeqësojnë më tej këtë situatë. Nevojitet edukim financiar i synuar, si dhe produkte bankare të përshtatura dhe të qëndrueshme, jo vetëm gjatë fushatave të marketingut. Bashkëpunimi me Shoqatën e Bankave është thelbësor. Gjithashtu, vonesat në verifikimin e kolateralit nga Kadastra përbëjnë një pengesë shtesë në këtë proces.

Znj. Sabi Osmani

Drejtoresh Ekzekutive, Dhoma Ekonomike e Gruas, 12 nëntor 2024



Lexo më shumë: [Notë Teknike “Akesi në Financë – Për Përmirësimin e Instrumenteve të Financimit”](#)

KONSULTIME TEKNIKE



Gjatë vitit 2024, Sekretariati vijoi të shërbejë si një platformë e rëndësishme për dialogun e strukturuar publik-privat, duke organizuar shtatë konsultime në nivel teknik. Këto takime mbledhën së bashku përfaqësues teknikë nga institucionet publike, sektori privat dhe partnerët për zhvillim, me qëllim informimin dhe validimin e rekomandimeve të hartuara nga Sekretariati.

- » **Konsultim mbi Informalitetin, Produktivitetin dhe Inovacionin.** Një fokus-grup i dedikuar u zhvillua me ekspertë të sektorit për të shqyrtuar sfidat lidhur me informalitetin, produktivitetin e ulët dhe pengesat ndaj inovacionit. Diskutimet u përqendruan në vlerësimin e masave të propozuara nga Sekretariati, duke synuar që ato të reflektonin situatën aktuale dhe të kishin vlerë praktike përpara prezantimit në KI.
- » **Konsultime për Aksesin dhe Konkurrueshmërinë në Tregun e BE-së.** Tre fokus-grupe u organizuan në bashkëpunim me anëtarët e KI-së dhe aktorë kyç të sektorit privat, përfshirë Shoqatën e Biznesit Grek në Shqipëri (HBAA), Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës dhe Shoqatën Kombëtare të Ndërtuesve (SHNSH). Diskutimet u fokusuan në përmirësimin e aksesit të produkteve shqiptare në tregjet e BE-së dhe rritjen e konkurrueshmërisë. Pjesëmarrësit kontribuan në identifikimin e prioritetëve të sektorëve përkatës dhe në adresimin e barrierave kritike ndaj eksportit dhe konkurrencës në tregje ndërkombëtare.
- » **Konsultime mbi Aksesin në Financë.** Dy sesione konsultimi mbi aksesin në financë u zhvilluan në bashkëpunim me Dhomën Ekonomike të Gruas (DHEG), Shoqatën e Bankave dhe Bankën e Shqipërisë. Diskutimet u fokusuan mbi gjetjet e një ankete të zhvilluar nga Sekretariati me NMVM-të, duke theksuar nevojën për thjeshtim të procedurave, ulje të barrës administrative dhe promovim të instrumenteve alternative të financimit, si garancitë sovraane dhe mjetet digjitale financiare.
- » **Konsultim mbi Parkun Teknologjik “Durana”.** Në bashkëpunim me Korporatën Shqiptare të Investimeve, Sekretariati organizoi një konsultim të hapur mbi planin e zhvillimit të Parkut Teknologjik “Durana”. Mbi 40 palë të interesuara, përfshirë kompani teknologjike ndërkombëtare, biznese vendase dhe startup-e, morën pjesë në diskutimet mbi potencialin e parkut për të nxitur një ekosistem inovacioni dhe për të kontribuar në transformimin digjital të ekonomisë shqiptare.

REKOMANDIME TË PËRMBUSHURA GJATË VITIT 2024

Që prej krijimit në vitin 2015, KI ka miratuar 350 rekomandime për përmirësimin e klimës së investimeve në Shqipëri. Sekretariati ka vijuar të promovojë transparencën dhe llogaridhënien, përmes raportimeve të rregullta mbi ecurinë e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

STATUSI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE (2015-2024)

47%

TË PËRMBUSHURA

17%

NË PROCES

36%

NË PRITJE TË ZBATIMIT



Fushat Kryesore të Ndikimit gjatë vitit 2024

TURIZËM

- » Miratimi i Ligjit Nr. 30/2024, në prill 2024, shënoi një hap të rëndësishëm drejt formalizimit të sektorit turistik dhe përmirësimit të cilësisë së akomodimit.
- » U prezantuan kategori të reja klasifikimi dhe standarde certifikimi për strukturat turistike, të menaxhuara nga Ministria përgjegjëse.
- » U krijua Komiteti për të Dhënat Statistikore në Turizëm, me fokus në përmirësimin e raportimit dhe analizës së të dhënave për politika më të informuara.

BUJQËSI

- » Inventarizimi i tokës bujqësore vijoi në disa bashki, me krijimin e regjistrave digjitalë dhe aktivizimin e sistemit WEB-GIS në portalin e-Albania.
- » Skema Kombëtare e Mbështetjes 2024 fokusohet tek grupet e fermerëve dhe kooperativat, duke përfshirë një skemë garancie sovra në zhvillim për kreditimin në sektorin agro-ushqimor.
- » Përditësimi i Regjistrit të Fermerit, i integruar me sistemet e AZHBR-së dhe ndërlidhja me bazën e të dhënave kombëtare për përmirësimin e aplikimeve dhe shërbimeve.
- » Brenda Ministrisë së Bujqësisë u krijua një departament i posaçëm për statistika dhe analiza, i cili bashkëpunon me INSTAT për zhvillimin e politikave të bazuara në të dhëna.

AGRO-PËRPUNIM

- » U arritën marrëveshje rajonale për njohjen reciproke të certifikatave fitosanitare me vendet e Ballkanit Perëndimor.
- » Shqipëria përfundoi praktikën me standardet ndërkombëtare IPPC, ndërsa platforma CEFTA TRACES NT po përdoret për lëshimin elektronik të certifikatave fitosanitare.
- » ISUV përfitoi fonde për rritjen e kapaciteteve laboratorike dhe po punon për akreditimin në analizën e mbetjeve të pesticideve.
- » MBZHR mbështeti promovimin ndërkombëtar të produkteve shqiptare në panaire, duke shtuar ekspozimin dhe qasjen në treg për fruta, perime, verëra dhe bimë medicinale.

TË GJITHË SEKTORËT – TATIMI I DYFISHTË DHE PROCEDURAT ELEKTRONIKE

- » Janë miratuar dy direktiva të reja në vitin 2024, që modernizojnë dokumentacionin tatimor, njohin nënshkrimin elektronik dhe fuqizojnë luftën ndaj evazionit fiskal, duke lehtësuar procedurat për tatimpaguesit.

BANKINGU DIGJITAL DHE BANKINGU I HAPUR

- » Licencimi i institucionit të parë të Open Banking në Shqipëri (EasyPay) shënoi një hap drejt konkurrencës më të lartë dhe aksesit të zgjeruar në financë për grupet e pashërbyera.

REFORMA NË INSPEKTIM & STRATEGJIA FISKALE

- » Ligji Nr. 99/2024 për inspektimin forcon kontrollet, standardizon procedurat dhe i përaftron ato me legjislacionin e BE-së.
- » Strategjia Afatmesme e të Ardhurave 2024–2027 u miratua për të përmirësuar qeverisjen ekonomike dhe për të reduktuar informalitetin.

AGJENDA KOMBËTARE E REFORMAVE 2025–2027

- » U miratua një plan i ri reformash me mbështetjen e BE-së, i fokusuar në kapitalin njerëzor, arsimin dhe specializimin inteligjent, me ndikim në mbi 125,000 ndërmarrje.

PAGESAT DIGJITALE PËR SHËRBIMET PUBLIKE

- » U nënshkrua një memorandum bashkëpunimi për mundësimin e pagesave publike online përmes bankave dhe e-Albania.

NDËRMJETËSIMI NË PUNËSIM & SIGURIA KIBERNETIKE

- » Platforma puna.gov.al është përditësuar me oferta pune dhe janë intensifikuar bashkëpunimet për nxitjen e ndërmjetësimit në punësim.
- » AKSHI ka zbatuar masa për sigurinë kibernetike dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve publike digjitale.


Pavarësisht përparimeve në zbatimin e rekomandimeve, 36% e rekomandimeve mbeten ende të pazbatuara, veçanërisht në fusha si siguria ligjore e pronës, diversifikimi i burimeve të energjisë dhe tërheqja e investimeve të huaja direkte. Përsheptimi i progresit do të kërkojë një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, si dhe një mbështetje të qëndrueshme për zbatimin efektiv të reformave.

FORCIMI I ZBATIMIT TË REFORMAVE

Zbatimi i rekomandimeve të KI është lehtësuar dhe forcuar në sajë të mbështetjes me projekte vijuese nën drejtimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe mbështetjes së Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

Një prej këtyre iniciativave është projekti i asistencës teknike që mbështet Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës (AKK), i cili nisi në shtator 2023 dhe vijoi gjatë gjithë vitit 2024. Projekti synon të rrisë kapacitetet zbatuese të AKK-së, të përmirësojë pajtueshmërinë e bizneseve me rregullat e konkurrencës në sektorët prioritarë dhe të mbështesë procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE në kuadër të Kapitullit 8. Progres është shënuar në dy komponentë: (1)

përafrimi i legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së, përfshirë hartimin e ndryshimeve në Ligjin për Konkurrencën dhe transpozimin e shtatë direktivave dhe rregulloreve të rëndësishme të BE-së; dhe (2) forcimi i zbatimit dhe promovimi i një kulture konkurrence, përmes bashkëpunimit me UNCTAD, e cila kreu një vlerësim të nevojave për trajnim dhe organizoi një kurs dyditor për 15 gjyqtarë dhe magjistratë në Shkollën e Magjistraturës. Trajnime të mëtejshme janë planifikuar për në fillim të vitit 2025.



KOMUNIKIM DHE VIZIBILITET



FAQJA E INTERNETIT:

» +61,000 përdorues në 2024

MEDIAT SOCIALE:

» Aktiv në 3 platforma: Facebook, LinkedIn, X
» 21% rritje në numrin e ndjekësve (4,857 në 2024 vs 4,013 në 2023)

BULETINË TREMUJORË

Shpërndarë në mënyrë elektronike tek të gjithë partnerët e KI-së dhe postuar në mediat sociale.

» [Janar-Mars 2024](#)
» [Prill-Qershor 2024](#)
» [Korrik-Shtator 2024](#)
» [Tetor-Dhjetor 2024](#)

ARTIKULL NË MEDIAN E SHKRUAR

» [Intervistë me znj. Diana Leka, Drejtore e Sekretariatit: “Sfidat e Konkurrueshmërisë”](#)
– *Revista Monitor*, 8 mars 2024

PREZENCË MEDIATIKE NË KANALET KOMBËTARE TELEVIZIVE

» TV Klan

[Sondazhi me bizneset: Informaliteti, ende prezent](#) – 17 prill 2024

[Bizneset shqiptare, më pak vëmendje nga inovacioni](#) – 8 maj 2024

[Konkurrueshmëria dhe Aksesit në Financë në Fokus të Këshillit të Investimeve](#) – 5 shtator 2024

» Report TV

[Anketa: Biznesi në vend kërkon më shumë se 5.700 punonjës! Ja profesionet që kërkohen](#) – 16 prill 2024

[Vrojtimi i Këshillit të Investimeve, rritet mosdeklarimi i pagave reale](#) – 19 prill 2024

» ABC News

[Bankat japin më shumë hua/Këshilli i Investimeve: Bizneset po marrin kredi për zgjerim të aktivitetit](#) – 24 dhjetor 2024

MARKETING ME E-MAIL

(shpërndarja e lajmeve)

» 1,100 të abonuar
» Shpërndarë në anglisht dhe shqip
» 22% mesatarja e leximit të njoftimeve

ANGAZHIMI I PARTNERËVE

Gjatë vitit 2024, KI shënoi një rritje të kontributit dhe angazhimit nga sektori privat dhe institucionet e reja.

143

përfaqësues të biznesit morën pjesë në mbledhje të KI dhe mbledhje teknike.

3

mbledhje të KI u drejtuan nga Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me një nivel pjesëmarrjeje prej **88%** nga anëtarët.

5

anketa me pjesëmarrjen e **984 kompanive**.

7

fokus grupe me pjesëmarrjen e **73 përfaqësuesve të biznesit dhe ekspertëve të pavarur**.

Pjesëmarrja gjinore në aktivitetet e KI:

57% **43%**
gra **burra**

122

gra morën pjesë në mbledhjet e Këshillit dhe fokus grupe.

Shoqatat dhe dhomat e biznesit brenda KI përfaqësojnë interesat e **2,113 kompanive** (sipas të dhënave të përditësuara të anëtarësisë). Bashkëpunimet e reja përfshijnë një seminar me Korporatën Shqiptare të Investimeve (AIC) dhe kontributit në rritjen e ndërgjegjësimit mbi rekomandimet e Këshillit të Investimeve përmes pjesëmarrjes në aktivitete të nivelit të lartë.



AVOKIM DHE NDËRGJEGJËSIM

SHIFRA KRYESORE

16

Kontribute në aktivitete dhe konferenca të partnerëve

3

Anëtar jurie në konkurse startup-esh

12

Prezantime ose diskutime në panele të ndryshme

3

Bashkëpunime me institucione akademike

3

Kontribute në webinarë rajonale

Bashkëpunimi midis KI dhe Akademisë – Konkursi “Tung Ideas” nga Universiteti Epoka

23 SHKURT 2024

Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm midis KI dhe Universitetit Epoka, nisur që në vitin 2017, Drejtuesja e Sekretariatit mori pjesë si anëtar jurie në konkursin për startup-et “Tung Ideve”. Ky konkurs, i zhvilluar në formën e një workshopi dhe frymëzuar nga shkolla ndërkombëtare të njohura, kishte si qëllim inkurajimin e aftësive sipërmarrëse të studentëve për të adresuar problematika sociale dhe biznesi duke përdorur metoda inovative të mendimit dhe dizajnit. Gjatë viteve, ky partneritet ka përfshirë bashkëpunimin me studentë në anketime mbi sfidat e klimës së investimeve, pjesëmarrjen dhe kontributin e Sekretariatit në simpoziume shkencore të universitetit, si dhe përkrahjen e studentëve të dalluar në përgatitjen dhe botimin e punimeve shkencore, përmes analizave të thelluara dhe krahasimore të gjetjeve të anketave dhe studimeve të Sekretariatit nga viti 2015 deri në 2024 mbi tema që prekin biznesin.

Vlerësim mbi Gatishmërinë e Gjykatave Online

29 SHKURT 2024

Eksperti Ligjor dhe Rregullator i Sekretariatit mori pjesë

si panelist në një webinar rajonal me temë “Vlerësim mbi Gatishmërinë e Gjykatave Online,” organizuar në kuadër të një projekti të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga 17 vende anëtare të BERZH-it, ku diskutimi u përqendrua në situatën e gjykatave online dhe u propozuan hapa konkretë për nxitjen e funksionimit të tyre. Gjatë ndërhyrjes së tij, eksperti theksoi nevojën për projekte të dedikuara që fokusohen në transformimin digjital të gjykatave në Shqipëri, me qëllim rritjen e aksesit në drejtësi, uljen e kostove dhe përmirësimin e efikasitetit, veçanërisht për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Bashkëpunim me akademinë: Avokim i rekomandimeve të KI mbi kapitalin njerëzor dhe cilësinë e aftësive

23 PRILL 2024

Në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës (FEUT), Drejtuesja e Sekretariatit mori pjesë në një panel diskutimi gjatë Panairit të Punës të FEUT. Që nga viti 2015, Këshilli i Investimeve ka luajtur një rol aktiv në avokimin për përmirësimin e cilësisë së aftësive të punës dhe nxitjen e bashkëpunimit më të fortë midis akademisë dhe sektorit privat. Duke



njohur boshllëqet në aftësi si një pengesë kryesore për investimet private, KI ka avokuar vazhdimisht përafrimin e kurrikulave arsimore me kërkesat e tregut dhe mbështetjen e iniciativave inovative të trajnimit. Në vitin 2024, ky fokus mbetet thelbësor në përpjekjet e KI për të forcuar konkurrueshmërinë e Shqipërisë përmes zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Ceremonia e Çmimeve “Bright Mind 2024”

11 MAJ 2024

Drejtuesja e Sekretariatit mori pjesë në mbrëmjen gala “Bright Mind 2024”, organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare (ABDC), anëtare e KI. Gjatë eventit, ajo pati nderin t’i dorëzojë një çmim Shoqatës së Kontabilistëve Shqiptarë në Itali (AD-CAI), si shenjë vlerësimi për kontributin e tyre. Po ashtu, ajo i inkurajoi të angazhohen aktivisht përmes ABDC, duke ndarë njohuritë dhe sugjerimet për përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri.

Get in the Ring Albania 2024

28 MAY 2024

Drejtuesja e Sekretariatit ishte anëtarë jurie në konkursin e startup-eve “Get in the Ring Albania

2024”. Kjo ngjarje dinamike mbledhi një spektër të gjerë pjesëmarrësish, përfshirë sipërmarrës të rinj aspirantë dhe aktorë të rëndësishëm nga sektori publik, privat dhe partnerë për zhvillim. Ky bashkëpunim thekson angazhimin e Këshillit të Investimeve, që prej vitit 2016, për të promovuar inovacionin dhe sipërmarrjen në Shqipëri, duke mbështetur drejtuesit e rinj të biznesit që synojnë të kenë një ndikim të rëndësishëm në ekosistemin e startup-eve.

Kontribut në Konferencën e Dhomës Amerikane dhe Revistës Monitor: “Ristrukturimi ekonomik për një perspektivë të re”

24 QERSHOR 2024

Drejtoresha e Sekretariatit kontribuoi në një nga panelet e kësaj konference, ku diskutoi sfidat e informalitetit dhe mënyrat për të forcuar klimën ekonomike në Shqipëri. Gjatë fjalës së saj, ajo theksoi tre pika kyçe: së pari, nevojën për një vizion të qartë që adreson kompleksitetin e ekonomisë informale; së dyti, rëndësinë e mbledhjes së të dhënave dhe analizave të detajuara; dhe së treti, domosdoshmërinë e harmonizimit me reforma të rëndësishme kombëtare. Po ashtu, ajo theksoi nevojën për politika të



qëndrueshme që mbështesin formalizimin e ekonomisë, pavarësisht ndryshimeve politike, zgjerimin e bazës së tatimpaguesve dhe edukimin e vazhdueshëm në bashkëpunim me komunitetin e biznesit.

Sekretariati kontribuon në Forumin e Konektivitetit Tiranë 2024

10 SHTATOR 2024

Në Forumin e Konektivitetit Tiranë 2024, në panelin “Rritja e Pjesëmarrjes së Sektorit Privat në Iniciativat e Konektivitetit të Mbështetura nga BE”, Drejtuesja e Sekretariatit prezantoi gjetje kryesore nga analizat e KI mbi ndërkombëtarizimin e NVM-ve dhe përputhshmërinë me standardet e BE-së. Ajo theksoi përparimet në digjitalizim, tranzicionin digjital dhe përthithjen e fondeve. Gjithashtu, diskutoi përmirësimet në SEPA, korridoret e gjelbra dhe infrastrukturën e roaming-ut, duke nxjerrë në pah rëndësinë e zhvillimit të investimeve të gjelbra dhe digjitale për të mbështetur integrimin e Shqipërisë në Tregun e Përbashkët të BE-së.

Kontribut në Webinarin Rajonal të Helvetas: Nxitja e Ndërveprimit Ndërmjet Sektorit Privat dhe Shoqërisë Civile për Ndryshim

19 SHTATOR 2024

Në webinarin rajonal për Ballkanin Perëndimor, organizuar nga Helvetas në bashkëpunim me Reconomy dhe ETF, Drejtoria e Sekretariatit prezantoi metodologjinë e ‘vlerave të përbashkëta’ të KI. Kjo qasje përfshin dialogun gjithëpërfshirës ndërmjet institucioneve publike, sektorit privat dhe partnerëve për zhvillim, i bazuar në fakte. KI ka fuqizuar palët e interesuara për të mbrojtur interesat e tyre dhe ka krijuar një mjedis me të drejta të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit.

Kontribut në Samitin e 5-të të Grave Shqiptare të Diasporës, “Duke Udhëhequr Rrugën Drejt Bashkimit Evropian”

11 TETOR 2024

Drejtuesja e Sekretariatit mori pjesë në panelin “Udhëzimi i Bizneseve Drejt Integritimit në Tregun Evropian”, duke ndarë përvojën e Këshillit që nga viti 2015. Ajo theksoi rëndësinë e dialogut të bazuar në të dhëna për rritjen e transparencës dhe përmirësimin e klimës së investimeve. Gjithashtu trajtoi sfidat që përballen gratë sipërmarrëse në ndërkombëtarizimin e bizneseve dhe përmbushjen e standardeve të BE-së. Pavarësisht pengesave, gratë

shfaqin një optimizëm më të madh se burrat, duke theksuar nevojën për forcimin e aftësive dixhitale, sigurinë e të dhënave, menaxhimin e kostove dhe transparencën. Ajo bëri thirrje për integrimin e treguesve gjinorë në paketat e ardhshme të garancisë sovrane dhe inkurajoi sipërmarrësit të angazhohen më aktivisht në shoqatat e biznesit për të përfutur nga mundësitë e integritimit në BE.

Kontribut në Javën Ndërkombëtare të Sipërmarrjes

18-21 NËNTOR 2024

Gjatë Javës Ndërkombëtare të Sipërmarrjes, Sekretariati i KI kontribuoi në katër ngjarje kryesore. Në një seminar rajonal të organizuar nga MEKI, CEI dhe SEECP, Sekretariati theksoi gjetjet kryesore mbi sigurinë ligjore të pronës, sfidat e kadastrës, potencialin e investimeve dhe nevojën për përafrimin e kuadrit ligjor me standardet e investimeve të huaja. Në një forum mbi Ekonominë Qarkore të organizuar nga Universiteti Epoka, duke u mbështetur në raste dhe shqetësime konkrete të biznesit, Sekretariati theksoi rolin e arsimit dhe sektorit privat në promovimin e zgjidhjeve të gjelbra, inteligjente dhe digjitale që përputhen me reformat e BE-së. Ndërkohë, në një panel të organizuar nga Banka Botërore dhe IFC, Sekretariati ndau njohuri të nxjerra nga anketat dhe analizat e biznesit të fokusuar në aksesin në financë,

konkurrencën vendase në tregjet financiare, inovacionin në produktet financiare dhe forcimin e kapaciteteve të NMVM-ve.

Kontribut në evente të tjera

DHJETOR 2024

Në një forum biznesi të nivelit të lartë të organizuar nga Korporata Shqiptare e Investimeve, Sekretariati theksoi rëndësinë e një dialogu paraprak dhe gjithëpërfshirës, si dhe përshtetimin e reformave për kadastrën dhe regjistrimin e pronës shtetërore, duke i cilësuar këto si elementë thelbësorë për rritjen e besimit të investitorëve. Ai theksoi gjithashtu nevojën për përafrimin e projekteve të reja me objektivat e një ekonomie të gjelbër dhe digjitale. Në Ceremoninë Mbyllëse të Javës së Integritetit, organizuar nga Ministria e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Sekretariati theksoi rëndësinë e ndërtimit të besimit përmes krijimit të institucioneve të forta dhe ofrimit të shërbimeve transparente e të qëndrueshme për bizneset, duke u mbështetur në analizat e KI, veçanërisht mbi shërbime si inspektimet, taksat dhe doganat. Në një aktivitet organizuar nga CDI në bashkëpunim me Ambasadën Holandeze mbi integrimin në BE, Sekretariati theksoi rëndësinë e angazhimit qytetar në këtë proces unik, si dhe mbështetjen e vazhdueshme të KI për bashkëpunimin me sektorin privat, duke u bazuar në përvojën e akumuluar ndër vite.

ANKETAT E KI GJATË 2024



Në vitin 2024, KI vazhdoi angazhimin për të nxitur një dialog të bazuar në evidenca, duke zhvilluar 5 anketa gjithëpërfshirëse me pjesëmarrjen e 984 kompanive. Këto anketa shërbejnë si një mjet kyç për mbledhjen e përvojave dhe perspektivave reale të komunitetit të biznesit, në përputhje me metodologjinë nga poshtë lart që Këshilli ka ndjekur që prej krijimit të tij në vitin 2015.

Vrojtimet u përqendruan në disa prej fushave kryesore të zhvillimit të sektorit privat në vend:

Sfidat e sektorit privat – Identifikimi i pengesave strukturore si informaliteti, produktiviteti i ulët dhe kapacitetet e kufizuara për inovacion, që kufizojnë rritjen e qëndrueshme të ndërmarrjeve.

Akses në tregje – Vlerësimi i përgatitjes së produkteve shqiptare jo-ushqimore për përmbushjen e standardeve të BE-së, me fokus në zgjerimin e eksportit dhe rritjen e konkurrueshmërisë rajonale.

Akses në financë (perspektiva e biznesit) – Shqyrtimi i pengesave që ndërmarrjet hasin kur kërkojnë mbështetje financiare.

Akses në financë (perspektiva e sektorit bankar) – Vlerësimi i praktikave dhe sfidave në financimin e NMVM-ve nga këndvështrimi i institucioneve bankare.

Akses në financë (perspektiva e mikrofinancës) – Kuptimi i rolit të institucioneve të mikrofinancës në ofrimin e mbështetjes për NMVM-të dhe përfshirjes financiare.



Kliko për më shumë informacion.

DOKUMENTE

Mars 2024

- » Mbledhja XXXIII – Agjenda
- » Mbledhja XXXIII – Prezantim PPT
- » Mbledhja XXXIII – Dokument Pune “Sfidat e Sektorit Privat: Informaliteti, Produktiviteti, Inovacioni”
- » Gjetjet e Vrojtimit – Sfidat e Sektorit Privat: Informaliteti, Produktiviteti, dhe Inovacioni
- » Mbledhja XXXIII – Matrica e Rekomandimeve
- » Mbledhja XXXIII – Minutat

SHTATOR 2024

- » Mbledhja XXXIV – Agjenda
- » Mbledhja XXXIV – Prezantim PPT
- » Mbledhja XXXIV – Dokument Pune “Për Përmirësimin e Konkurrueshmërisë dhe Aksesit të Tregje të Produkteve Jo-Ushqimore Shqiptare me Standarde Evropiane”
- » Gjetjet e Vrojtimit – Për Përmirësimin e Konkurrueshmërisë dhe Aksesit të Tregje të Produkteve Jo-Ushqimore Shqiptare me Standarde Evropiane
- » Mbledhja XXXIV – Matrica e Rekomandimeve
- » Mbledhja XXXIV – Minutat
- » Prezantim PPT – Progresi i Rekomandimeve të KI, Janar-Qershor 2024

NËNTOR 2024

- » Mbledhja XXXV – Agjenda
- » Mbledhja XXXV – Prezantim PPT
- » Mbledhja XXXV – Dokument Pune “Për Përmirësimin e Instrumenteve të Financimit”
- » Gjetjet e Vrojtimit – Perspektiva e Biznesit mbi Aksesin në Financë
- » Gjetjet e Vrojtimit – Perspektiva e Sistemit Bankar mbi Financimin e Ndërmarrjeve
- » Gjetjet e Vrojtimit – Perspektiva e Mikrofinancës mbi Financimin e Ndërmarrjeve
- » Mbledhja XXXV – Matrica e Rekomandimeve
- » Mbledhja XXXV – Minutat

PUBLIKIME

- » Përmbledhje mbi Treguesit Makro-Ekonomikë, 2024
- » Përmbledhje mbi Treguesit Makro-Ekonomikë, Janar-Qershor 2024
- » Raportim mbi Progresin e Rekomandimeve të KI (Korrik 2024)
- » Raporti i Aktiviteteve, 2023
- » Raporti i Monitorimit të Rekomandimeve, 2023
- » Vlerësim nga Anëtarë dhe Partnerë të Këshillit të Investimeve, 2024

PLANET *PËR TË* **ARDHMEN**

Kdo të vazhdojë të shërbejë si një platformë e rëndësishme për nxitjen e dialogut konstruktiv ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat, me synimin për të rindërtuar besimin e investitorëve, për të përmirësuar klimën e biznesit dhe për të adresuar sfidat e zhvillimit me ndikim afatmesëm dhe afatgjatë. Në agjendën e miratuar për vitin 2025, anëtarët e Këshillit kanë vendosur si prioritet çështjen e sfidave që bizneset përballin me shërbimet e qeverisjes vendore, me fokus të veçantë në përmirësimin e efikasitetit përmes digjitalizimit.

Numra të rëndësishëm 2024

3 MBLEDHJE TË KI	24 REKOMANDIME TË MIRATUARA
12 REKOMANDIME TË ZBATUARA, 12 NË PROCES	10 DOKUMENTE ANALITIKE
+20 DHOMA/SHOQATA TË BIZNESIT TË ANGAZHUARA NË AKTIVITETE TË KI	2,113 BIZNESE TË PËRFAQËSUARA NGA DHOMAT/SHOQATAT ANËTARE NË KI
5 VROJTIME	984 KOMPANI PJESEMARRËSE NË VROJTIME
143 BIZNESE PJESEMARRËSE NË MBLEDHJE TË KI, DHE MBLEDHJE TË TJERA TEKNIKE	7 FOKUS GRUPE
1 RAPORT VJETOR MONITORIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KI	1,100 TË ABONUAR NË FAQEN E KI
88% NIVELI I PJESEMARRJES SË ANËTARËVE NË MBLEDHJE TË KI	4,857 NDJEKËS NË MEDIAT SOCIALE
PJESEMARRJA GJINORE NË AKTIVITETE TË KI: 43% BURRA 57% GRA	

Anëtarë të KI 2024

Anëtarë, Institucione Shtetërore	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
	Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
	Banka e Shqipërisë
	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)
	Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
Anëtarë, Partnerë për Zhvillim	Banka Botërore
	Delegacioni i BE-së në Shqipëri
	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)
	Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)
Anëtarë të Biznesit me Mandat të Përhershëm	Dhoma e Industrisë dhe Tregtisë Tiranë
	Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
	Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare (ADBC)
Anëtarë të Biznesit me Mandat 2-Vjeçar	Shoqata e Investitorë të Huaj në Shqipëri (FIAA)
	Shoqata e Bankave (AAB)
	Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC Albania)
	Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)
	Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham)
	Shoqata Shqiptare e Tregtisë Elektronike (AECA)
	Confindustria Albania
	Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri (HBAA)
Anëtarë të Tjerë të Biznesit	Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA)
	Instituti i Ekspertëve Kontabët të Autorizuar (IEKA)
	Pendl & Piswaenger
	Emante Panel
	Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës (AMA)
	Shoqata “Proeksport Albania” (PEA)



Improving Transparency and Investment Climate

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha


Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

Albania Investment Council ALInvestCouncil Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).